



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 697/5 Prot

Tiranë, më 12 . 12 .2025

V E N D I M

Nr. 76 , datë 12 / 12 /2025

Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore Këshilli i Qarkut Shkodër dhe përfundimin e procesit të mbikëqyrjes.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar; në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i ndryshuar, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Këshilli i Qarkut Shkodër,

V Ë R E J S E:

Me urdhërin nr. 67 (697 prot.), datë 7.7.2025, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil, në Këshillin e Qarkut Shkodër”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka filluar mbikëqyrjen në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë nga ana e subjekteve të ngarkuara me detyra specifike për administrimin e procesit të rekrutimit dhe të disiplinës në shërbimin civil.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 697/1 prot., datë 7.7.2025, të miratuar nga Komisioneri, njoftuar Këshillit të Qarkut Shkodër me shkresën nr. 696/2 prot., datë 7.7.2025, “Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në Këshillin e Qarkut Shkodër”.

Objekti i mbikëqyrjes është zbatimi i ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet pranimi në shërbimin civil; lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil, duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjit me detyra specifike për administrimin e këtij procesi.

Mënyra e administrimit të shërbimit civil në Këshillin e Qarkut Shkodër, si njësi e qeverisjes vendore, bazohet në nenin 2, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ku është parashikuar në mënyrë të shprehur se: “*fusha e veprimit të tij shtrihet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik, në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur, apo njësi të qeverisjes vendore*”.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i punës ka hartuar projektraportin për situatën e konstatuar, i cili i është dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 697/3 prot., datë 25.11.2025, të Komisionerit, duke i lënë 5 ditë kohë për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes.

Ndërkohë, subjekti i mbikëqyrur pasi është njohur me projektraportin nëpërmjet shkresës nr. 761/1 prot., datë 4.12.2025, “*Sqarime lidhur me konkluzionet e Kapitullit VII të Raportit të Mbikëqyrjes*”, ka dërguar të nënshkruar projektraportin dhe pa vërejtje.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, Komisioneri ka evidentuar disa mangësi të administrimit të shërbimit civil, të cilat po i paraqesim në vijim:

- ✓ Gjatë mbikëqyrjes në institucion është konstatuar se për vitin 2024, nuk është hartuar plani vjetor i pranimi në shërbimin civil, brenda afatit të përcaktuar në ligj, që përkon me muajin Shkurt të vitit kalendarik. Ndërkohë, rezulton se kjo situatë është rregulluar përgjatë vitit 2025 nga subjekti i mbikëqyrur.

Sjellim në vëmendje të njësisë së burimeve njerëzore të institucionit se, hartimi i planit vjetor të pranimi në shërbimin civil, i cili përfshin vendet vakante të institucionit, si edhe vendet e lira që mund të krijohen gjatë vitit në vijim brenda afatit ligjor, ka një rëndësi të veçantë pasi shërben si bazë për shpalljen e procedurave të konkurrimit për plotësimin e vendeve të lira, si dhe realizimin në kohë të tyre, në zbatim të ligjit.

- ✓ Gjatë këqyrjes së dokumentacionit të administruar të procedurave të konkurrimit, rezultoi se, për kryerjen e vlerësimit me shkrim të kandidatëve, anëtarët e KPP, kanë hartuar testet përkatëse, të cilat janë paraprirë nga procesverbali për përzgjedhjen e pyetjeve, i mbajtur nga anëtarët e KPP, ndërsa përgjigja e saktë për secilën pyetje (çelësi i përgjigjeve), të cilën Anëtarët e Komitetit duhet ta kenë të administruar para zhvillimit të testimit, mungon.

Nga ana tjetër, konstatohet se, procedura e nëpunëses Valbona Perizi në fund të periudhës së provës nga eprori direkt, duke konfirmuar si nëpunës civil, është kryer në përputhje me kërkesat e ligjit, përveç mungesës së një elementi, që është caktimi i nëpunësit civil më të vjetër në detyrë dhe, si rezultat, mungon mendimi i tij me shkrim.

Sipas pikës 2, neni 24, i ligjit, si dhe kreut VI “*Periudha e provës*”, të VKM-së nr. 243, datë 18.3.2015 “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, i ndryshuar, caktimi i nëpunësit civil më të vjetër në detyrë për të udhëzuar nëpunësin në periudhë prove, është një element i domosdoshëm, për orientimin e nëpunësit të ri në kryerjen e detyrës dhe që duhet të përfshihet në aktin e emërimit.

Sa parashtruam më sipër, paraqesin disa elementë parregullsie që janë konstatuar nga mbikëqyrja në këtë institucion, të cilat nisur nga natyra e tyre, nuk çënojnë thelbin e proceseve të realizuara, e për më tepër janë rregulluar gjatë vitit 2025.

Parregullsitë janë pasqyruar në raport, me qëllim që të sillen në vëmendjen e subjekteve që kanë detyrë të administrojnë shërbimin civil dhe të mos përsëriten në të ardhmen, e ndërkohë do të jenë në fokusin e kontrollit të Komisionerit në vazhdimësi, për të mos lejuar përsëritjen e tyre.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, konstatova se, parregullsitë e konstatuara nuk janë të natyrës së shkeljeve ligjore që kërkojnë rregullime të posaçme për proceset e përfunduara, por duhet të mbahen parasysh gjatë proceseve në vijim, nga subjektet e cituara më sipër në vendim. Vërejtjet e pasqyruara në këtë akt, janë të karakterit parimor që nuk e çënojnë në thelb ndonjë prej proceseve të evidentuara, e në këto kushte, procesi i mbikëqyrjes nuk do të shoqërohet me vendim paralajmërimi.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, referuar Seksionit III “*Procedura hetimore*”, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, si dhe Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, e ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave për plotësimin e pozicioneve të lira në shërbimin civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore Këshilli i Qarkut Shkodër, i cili është pjesë e këtij vendimi dhe të përfundoj procesin e mbikëqyrjes në këtë institucion.

Problematicat e evidentuara në përmbajtjen e raportit përfundimtar, kanë të bëjnë me aspekte të përgjithshme të zbatimit të ligjit, e për këtë arsye, Komisioneri do të përmbyllë procesin pa vendim paralajmërues.

2. Për këtë vendim të njoftohet Këshilli i Qarkut Shkodër, duke i dërguar një kopje të vendimit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



Pranvera Strakosha